



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Likovë, 20 shtator 2012

Inaugurimi zyrtar i pjesës së sapo ndërtuar të shkollës 'Ismet Jashari'
Pjesë e Projektit IPA CBC; MK-BG
'Arsim, Ambient, Evropë... Evropë e Bashkuar'

Fjalim nga
Z-ja. Ingrid Sager
Shefe e Seksionit
Delegacioni i Bashkimit Evropian

I nderuar Kryetar i komunës,

Të nderuar misafirë,

Zonja dhe zotërinj,

- Kam kënaqësinë dhe nderin të jem sot këtu me rastin e inaugurimit të pjesës së sapo ndërtuar të shkollës, implementimi i të cilit ndërtim financohet nga projekti për Bashkëpunim Ndërkufitar mes Bullgarisë dhe Maqedonisë i quajtur 'Arsim, Ambient, Evropë... Evropë e Bashkuar'.
- Përvoja e Bashkimit Evropian dëshmon që zhvillimi i rajoneve kufitare është një faktor kyç për integrim evropian dhe reciprocitet shoqëror. Megjithatë, bashkëpunimi përtej kufijve është një proces i vështirë dhe rrallëherë spontan. Strukturat dhe autoritetet që kanë të bëjnë me kufijtë në nivele të ndryshme të qeverisjes dhe fuqisë duhet të mësohen të punojnë së bashku. Pengesat duhet të tejkalohen. Këto të fundit kanë të bëjnë me dallime në institucione politike, sisteme dhe procedura administrative, struktura ligjore dhe standarde teknike dhe mjedisore.
- Një nga aspektet më të rëndësishme të bashkëpunimit përtej kufijve është 'efekti i shumëfishimit' që prodhon ai; energjia që mobilizon dhe përvoja që fitohet prej tij. Për të përmirësuar kushtet ekonomike, shoqërore dhe kushtet e mjedisit të njerëzve që jetojnë në këtë rajon. Programet Ndërkufitare ndihmojnë përmirësimin e kushteve për jetesë të popullatës, përmes krijimit të përgjegjësiwe ekonomike dhe personale
- Instrumentet financiare të Bashkëpunimit Ndërkufitar të zhvilluara nga Bashkimi Evropian kontribuojnë në tejkalimin e pengesave të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në rajonet kufitare. Këto instrumente kontribuojnë

duke vendosur njerëzit në qendër të procesit të bashkëpunimit.

- Pjesa e saponjërtuar e shkollës 'Ismet Jashari' të cilën po e inaugurojmë sot, është pjesë e një projekti të madh që financohet nga Bashkimi Evropian me 255.000 EUR; Çmimet e përgjithshme të projektit arrijnë shumën prej 300.000 EUR dhe unë jam krenare që sot mund t'i shohim rezultatet e këtij projekti.
- Do të doja të përgëzoj Komunën e Likovës si partner udhëheqës të këtij projekti, Shoqatën Forumi Mjedisor nga Qystendilli, Republika e Bullgarisë si dhe Shkollën e Mesme Komunale Goce Dellçev – Kumanovë si partnerë të projektit për implementim të suksesshëm të këtij projekti!
- Do të doja gjithashtu të shfrytëzoj rastin për të inkurajuar autoritetet shtetërore të vazhdojnë përpjekjet për bashkëpunim ndërkuftar. Fryma e bashkëpunimit dhe shoqërisë që krijohen përmes programeve të tilla kontribuon për një të ardhme më të begatshme për të gjithë ne në një Evropë të Bashkuar!

Ju falenderoj shumë për vëmendjen!